



REPUBLIKA E SHQIPËRIË



V E N D I M

Nr.20 datë 30.12.2020

PËR PROPOZIMIN PËR DHËNIE SHITESË PENSIONI TË POSAÇËM SHTETËROR

Këshilli i Qarkut Shkodër i mbledhur sot më datë 30.12.2020, pasi mori në shqyrtim relacionin mbi projekt vendimin "Për propozimin për dhënie shitesë pensioni të posaçëm shtetëror", të përgatitur nga administrata dhe Kryetari i Këshillit të Qarkut, mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", në Ligjin Nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar), në VKM-në Nr. 429, datë 12.09.2002 "Për kushtet e përfutimit, shumën dhe procedurën e dhënies së pensioneve të posaçme shtetërore dhe shitesave të pensioneve të posaçme shtetërore"; Neni 12,13,15 i "Rregullores për organizimin dhe Funkionimin e Këshillit të Qarkut Shkodër". Bazuar në Aktin Normativ Nr.03 datë: 15.03.2020 konkretisht neni 5, " për vendmarrjen e organeve kolegjiale gjatë gjendjes së infeksionit Covid-19", si dhe bazuar në Urdhërin Nr.80 datë 17.11.2020 "për miratimin e rregullave dhe procedurave standarde të punës të harmonizuara, gjatë periudhës së gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga covid-19..."si dhe urdhërit nr.633 datë 17.11.2020 "për ndalimin e grumbullimeve me më shumë se 10 persona në vende të mbyllura apo të hapura..."

Duke marrë shkas nga situata e krijuar nga pandemia Covid-19, mbledhja e Këshillit të Qarkut Shkodër u zhvillua online nëpërmjet platformës Zoom, pas relativitetit nga zyra e drejtorisë së zhvillimit dhe bashkpunimit me jashtë dhe më pas diskutimit nga anëtarët e këshillit u kalua në procesin e votimit me e-mail ku u Miratua me **12 Vota Pro, 1 Vota Kundër**. Në përfundim Këshilli i Qarkut Shkodër

V E N D O S I

1. T'i propozojë Këshillit të Ministrave dhënien e shitesës së pensionit të posaçëm shtetëror për:

z. Fran Uk VUKAJ

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Administrata e Këshillit të Qarkut Shkodër.

3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 3 të nenit 78 të Ligjit Nr.139/2015

"Për vetëqeverisjen vendore".



Scanned with the
Scanner App



REPUBLIKA E SHQIPËRIË



RELACION

PËR PROJEKT -VENDIMIN

PËR DHËNIE SHITESE PENSIONI TË POSAÇËM SHTETËROR

Këshilli i Qarkut Shkodër i mbledhur sot më datë 30.12.2020, pasi mori në shqyrtim relacionin mbi projekt vendimin "Për propozimin për dhënie shtesë pensioni të posaçëm shtetëror", të përgatitur nga administrata dhe Kryetari i Këshillit të Qarkut, mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", në Ligjin Nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar), në VKM-në Nr. 429, datë 12.09.2002 "Për kushtet e përfitimit, shumën dhe procedurën e dhënies së pensioneve të posaçme shtetërore dhe shtesave të pensioneve të posaçme shtetërore"; Aktit- Normativ Nr. 3, datë 15.3.2020 "Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga Covid-19" si dhe Urdhrit nr. 80, datë 17.11.2020 "Për miratimin e rregullave dhe procedurave standarte të punës të harmonizuara, gjatë periudhës së gjendjes së pandemisë shkaktuar nga Covid-19.....", si dhe në kërkesën e subjektit,

Sipas Ligjit Nr. 7703, datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", me ndryshimet përkatëse, pensioni i posaçëm shtetëror apo shtesa e pensionit të posaçëm shtetëror u takon:

- a) *Personave që kanë marrë pjesë në lëvizjen e Rilindjes Kombëtare, në lëvizjet popullore, në luftën kundër pushtuesve nazi-fashistë brenda dhe jashtë Shqipërisë, në mbrojtjen e kufirit e ruajtjen e integritetit territorial të Shqipërisë dhe në lëvizjen demokratike dhe që kanë merita të veçanta.*
- b) *Personave që kanë arritur rezultate të dallueshme në fushën e shkencës, kulturës, arteve, ekonomisë dhe politikës.*
- c) *Personave që kanë vuajtur nga persekutimi politik në regjimin komunist.*

Në përputhje me dispozitat ligjore të mësipërme, akteve nënligjore dalë në zbatim të tyre si dhe në kërkesat e paraqitura pranë Këshillit të Qarkut Shkodër, pas një shqyrtimi që ju bë këtyre kërkesave dhe dosjeve që janë konform kritereve ligjore, ju paraqesim këtë propozim për shqyrtim të mëtejshëm për dhënien e shtesës së pensionit të posaçëm shtetëror, për:





Zotit Fran Uk Vukaj,

- lindur në Dardhë të Pukës me 04.06.1951,
- ka aktualisht një pension mujor pleqërie prej 30.464 (tridhjetë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e katër) lekë.
- Regjisor i parë artistik i rrethit të Pukës për 40 vite.
- Zakonet dhe traditat e jetës shqiptare të pasqyruara në krijimtarinë popullore, kanë qenë motoja e zotit Fran Vukaj, i cili gjatë karrierës së tij ka patur një veprimtari shumë të pasur krijuese me nivel të lartë artistik.
- Pjesëmarrës në shumë turne të zhvilluara si brenda vendit këtu në Shkodër, Lezhë, Gjirokastrë, Berat, e jashtë shtetit në Kosovë, Austri, Egjipt.
- Ka interpretuar dhe ka vënë në skenë mbi 80 drama, estrada, variete, komedi etj.
- Ka organizuar emisione televizive duke përcjellë vlerat më të mira të patriotizmit, nëpërmjet interpretimit të gjetur me fragmente të figurave të njohura kombëtare si Nënë Tereza, Isa Boletini, Adem Jashari, duke përcjelle vlerat e vërteta kombëtare që mbartin këto figura.
- Është botues i disa librave artistike dhe ka marrë vlerësime sikurse:
 "Mbresthënie"- poezi, "Njëren e ke falas", "Mozaik nga Metropoli"- përjetime, humor, publicistike; "Profile dhe Vlera" - publicistike, poezi, proze; 100 Buzëqeshje;
- Këshilli i Qarkut Shkodër i cili i ka akorduar titullin "Martin Camaj", në vitin 2006;
- Unioni Artistik i Kombit Shqiptar e ka vlerësuar si "Krenaria e Unionit" 16.04.2011;
- I është akorduar titulli vendor "Qytetar Nderi", nga Këshilli i Bashkisë Pukë me 09.09.2012,
- Është cilësuar si "Ambasador i Paqes", nga Federata Universale për Paqen.

Duke shpresuar në miratimin nga ana Juaj,

